



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**K.DH.SH.II.nr.850/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë**, gjyqtari Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) me seli në Prishtinë, Rr." Armend Daci nr. 1 në Prishtinë i paraqitur kundër debitorit të përmbarimit, K.D. nga shati ..., Komuna e Prizrenit, pronar i kompanisë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit, me bazë juridike përmbarimore kthimin e borxhit në shumën prej 5,580.74€, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.05/2013, të datës 11.01.2021, me datën 13.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e kreditorit "Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) me seli në Prishtinë, **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.05/2013, të datës 11.01.2021 dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomës së Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.05/2013, të datës 11.01.2021, në piken I të dispozitivit e ka refuzuar si e pabazuar kërkesën e dt. 10.11.2020 e palës kreditore, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) me seli në Prishtinë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, nga radha e trashëgimtareve të palës debitorë e për debitorin e përmbarimit, K.D. nga shati ..., Komuna e Prizrenit, si person fizik dhe pronar i kompanisë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit. Ndërsa në piken II të dispozitivit e ka shfuqizuar pjesërisht aktvendimi CP.nr.05/2013 i dt. 17.3.2013 për lejimin e përmbarimit si dhe anulohen pjesërisht të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra deri me tani çështjen juridike përmbarimore, CP.nr.05/2013 vetëm sa i përket palës debitorë, K.D. nga shati ..., Komuna e Prizrenit, si person fizik. Dhe në piken III të dispozitivit e ka përfunduar pjesërisht përmbarimi në çështjen juridike të përmbarimit, CP.nr.05/2013 për shkak se përmbarimi nuk mund të zbatohet sa i përket palës debitorë, K.D. nga shati ..., Komuna e Prizrenit, si person fizik dhe pronar i kompanisë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit, si person fizik. Ndërsa në piken IV ka mbetur pjesërisht në fuqi aktvendimi CP.nr.05/2013 i dt. 17.3.2013 për lejimin e përmbarimit si dhe anulohen pjesërisht të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra deri me tani çështjen juridike përmbarimore, CP.nr.05/2013 vetëm sa i përket palës debitorë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit, si biznes individual dhe se procedura e përmbarimit, do të vazhdojë vetëm sa i përket palës debitorë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit, si biznes individual.

Kundër atij aktvendimi, ne afat ligjor, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.05/2013, të datës 11.01.2021 dhe lënda të kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Dhoma e Shkalles e Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

*Ankesa e kreditorit është e themeltë.*

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e saj, CP.r.05/2023 të dt. 17.3.2013, ka lejuar propozimin për përmbartim të kreditorit të përmbartimit, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli në Prishtinë të paraqitur kundër debitorit të përmbartimit, K.D. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, pronar i kompanisë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit e për përmbartimin e dokumentit të përmbartimit - Vendimit administrativ të formës së prere, Nr.2025 të dt.23.7.2012 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli në Prishtinë për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 5,580.74 në emër të gjobës së shqiptuar administrative e për shkak të shfrytëzimit ilegal të resurseve minerare.

Duke proceduar me tej në këtë çështje juridike të përmbartimit, gjykata e shkallës së parë ka ndërmarr disa veprime përmbartimore derisa në ndërkohe, bashkëshortja e palës debitorë, i është drejtuar gjykatës, me parashtresën e dt.20.10.2020, e të cilës ia ka bashkangjitur kopjen e ekstraktit të vdekjes së palës debitorë e përmes të cilës provohet se pala debitorë, ka vdekur me dt.2.10.2020 derisa pala kreditore i është drejtuar gjykatë me kërkesën e dt.20.11.2020 për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të palës së vdekur debitorë nga radha e trashëgimtarëve të palës debitorë, K.D. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, pronar i kompanisë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit dhe se kjo gjykatë pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës, ka konstatuar dhe vlerësuar se kërkesa e palës kreditore për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për palën e vdekur kreditore, K.D. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, pronar i kompanisë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit dhe atë nga radha e trashëgimtarëve të tij, në çështjen juridike përmbartimore, C.nr. 05/2013, është i pabazuar derisa aktvendimi i gjykatës, CP.nr.05/2013 të dt. 17.3.2013 për lejimin e përmbartimit, duhet të shfuqizohet si dhe anulohen të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra përmbartimore në çështjen juridike përmbartimore, C.nr. 05/2013 derisa përmbartimi sipas detyrës zyrtare në çështjen juridike të përmbartimit, CP.nr.05/2013, duhet të përfundohet për shkak se përmbartimit nuk mund të zbatohet derisa procedura e përmbartimit sa i përket palës debitorë, kompanisë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit, si biznes individual, duhet të vazhdojë dhe atë për këto arsye: Me shikim në shkresat e lëndës, CP.r.05/2013, kjo gjykatë vërteton se në rastin konkret, kemi të bëjmë me propozimin për përmbartim të palës kreditore Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër debitorit të përmbartimit, K.D. nga fshatin ..., Komuna e Prizrenit, pronar i kompanisë, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit e për përmbartimin e dokumentit të përmbartimit - Vendimit administrativ të formës së prere, Nr.2025 të dt.23.7.2012 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli në Prishtinë për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 5,580.74 € në emër të gjobës së shqiptuar administrative e për shkak të shfrytëzimit ilegal të

resurseve minerare dhe i lejuar me aktvendimin e kësaj gjykatë, CP.r.05/2013 të dt. 17.5.2013 dhe se kjo gjykatës duke proceduar me tej ne këtë çështje juridike përmbartimore, ka ndërmarr disa veprime përmbartimore e përfshire edhe kërkesën për bllokim të xhirollogarive të palës debitorë si dhe kërkesën e gjykatës drejtuar Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve në Prizren për ndalimin e vazhdimin të regjistrimit të automjeteve të cilat janë prone e palës debitorë. Mirëpo duke qene se ne ndërkohe bashkëshortja e palës debitorë, e ka njoftuar se pala debitorë ka vdekur me dt.2.10.2020 e duke i propozuar gjykatës që në baze të nenit 340 të LMD-se, procedura përmbartimor të përfundohet pasi që me vdekjen e debitorit ishte shuar edhe detyrimi derisa pala kreditore me dt. 10.11.2020, i është drejtuar gjykatës, me kërkesën që pas vdekjes së palës debitorë, nga radha e trashëguesve të tij, të caktohet përfaqësuesi përkohshëm e në kuadër të institutit juridik të caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm për një pale kreditore në procedurën e përmbartimit e cila ka vdekur, por i cili edhe nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokur në kuptim të nenit 35 par.1 të LPP-se.

Po ashtu, Gjykata e shkallës së parë kam konstatuar se përkitazi me çështjen përfundimit të procedurës së përmbartimit në një çështje juridike të përmbartimit, sipas në rastin konkret dhe atë për shkak se përmbartim nuk mund të zbatohet, për këtë behet fjalë në nenin 66 par.3 të LPP-se e në të cilin, thuhet se : "*Përmbartimi do të përfundohet edhe kur ai është bere i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet*". Duke qene se në rastin konkret, pala debitorë, K.D. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit si person fizik, dhe pronar i pronar i kompanisë, NN." D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit, në ndërkohe ka vdekur, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se detyrimi i kërkuar në të holla nga pala kreditore ndaj palës debitorë, që është si gjobe e shqiptuar në procedurën administrative, nuk është detyrim në të holla që mund të bartet të trashëgimtar e palës debitorë sepse i atribuohet vetëm veçorive personale të palës debitorë e për këtë bëhet fjalë në nenin 340 të LMD-se e në të cilin, thuhet se : "*Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit shuhet detyrimi vetëm në qofte se është krijuar duke marrë parasysh veçoritë personale të njërit nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit*". Po ashtu për situatën juridike kur pale në procedure, është një biznes individual (BI), si në rastin konkret, N.N."D..." me seli në fshatin ... të Komunës së Prizrenit, për këtë behet fjale në nenin 48 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Nr. 06/L- 016 i dt. 15.3.2018 e që ka të beje me përgjegjësinë e pakufizuar, dhe se BI, nuk ishte person juridik, e në të cilin, thuhet se : "*Një person mund të këtë vetëm një Biznes Individual. Personi i cili është pronar i një Biznesi Individual, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontrate, në një Biznes Individual. Kjo përgjegjësi është e pakufizuar dhe përfshin tërë pronën dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të këtij Personi, pavarësisht nga fakti se nëse prona ose asetet e tilla shfrytëzohen për qëllime afariste, personale apo shtëpiake, përves pronës ose aseteve të përcaktuara në ligjin në fuqi për procedurën përmbartimore, dhe kur kontrata e cila e ka krijuar këtë përgjegjësi shprehimisht e përjashton nga përgjegjësia pronën ose asetet, personi ose shoqëria tregtare që ka pretendime është pajtuar që këto asetet ose prona të mos i nënshtrohen pretendimeve të tij. Prona ose asetet konsiderohen se janë në pronësi të tërthortë të një personi që është pronar i Biznesit Individual nëse ky person ka mundësi që të kontrollojë shfrytëzimin dhe disponimi e këtyre pronave ose aseteve; dhe ka dëshmi të mjaftueshme për të konkluduar se një person ose Shoqëri tjetër, është emëruar formalisht si pronar kryesor me qëllim të mbrojtjes së pronës ose aseteve nga përgjegjësia e pronarit të biznesit individual kurse në par.3 të nenit 48 të këtij ligji, thuhet se : "*Biznesi Individual nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ai mund të lidhe kontrate, të këtë pronë, të ushtroje padi dhe të jetë i paditur, në emrin e Biznesit Individual apo të pronarit. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur me decidivishtë si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.**

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë nuk mund ta pranoj qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, për faktin se kjo e fundit gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike kur vendimin e vet e ka mbështetur në vendimin administrativ të formës së prere me Nr.2025 të datës 23.07.2012 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), për shumën e detyrimit në vlerën prej 5,580.74€, ku me këtë rast përbarimi është lejuar në bazë të dokumentit përbarimor dhe në këtë rast ky dokument nuk paraqet dokument bazë për lejimin e përbarimit në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 21 dhe 22 të LPP-së, me arsyetimin se Vendimi Administrativ nuk është në origjinale, po ashtu nuk është kopje e vërtetuar siç parashihet sipas dispozitave ligjore në fuqi të LPP-se.

Prandaj, kjo gjykate vlerëson se Vendimi me Nr.2025 dt.23.07.2012 mbi të cilat është lejuar përbarimi nuk mund të jetë e pambarueshme pasi që nuk i plotëson kushtet thelbësore për të qenë dokument përbarimor të përshtatshme dhe të rregullt për përbarim dhe për këtë shkak ligjore nuk mund të ekzekutohet dërsi sa nuk i plotëson kushtet e parapara sipas dispozitave ligjore të LPP-së.

Po ashtu kjo gjykatë vlerëson se me dispozitën e nenit 38 par. 4 të Ligjit të Procedurës Përbarimorë përcaktohet se Neni 38 përcaktohet se *“në propozimi për përbarim duhet të kërkohej nëse Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohej përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohej të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*. Prandaj, në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se Aktvendimi Administrativ me Nr. 2025 të dt.23.07.2022 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ku ka shqiptuar gjobën në vlerën prej 5,580.74€ në emër të gjobës së shqiptuar administrative për shkak të shfrytëzimit ilegal të resurseve minerare dhe i lejuar me aktvendimin e gjykatës CP.nr. 05/2013 të dt.17.05.2023, nuk i plotëson kushtet të parapara më Ligjin e Procedurës Përbarimorë për tu vlerësuar si dokument përbarimor në kuptim të nenit 21 dhe 22 të LPP-së. Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret vendimi administrativ nuk mund të konsiderohet dokument përbarimor mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi, po ashtu nuk i plotëson kushtet për arsye se nuk është i papërshtatshëm për përbarim. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata e shkallës së dytë duke e pranuar si të themeltë pretendimin ankimor në këtë drejtim, çështjen vendosi t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Andaj, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt provat nga shkresat e lëndës sepse në këtë rast kjo gjykate vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për lejimin e përbarimit dhe nuk është i përshtatshëm për përbarim dhe nuk paraqet dokument të përshtatshëm për përbarim.

Prandaj, në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata e shkallës së dytë duke e pranuar si të themeltë pretendimin ankimor në këtë drejtim, çështjen vendosi t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vlerësojë edhe njëherë pretendimet e palës debitorë lidhur me prapësimin e tij, respektivisht të vlerësojë se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarrimit nga ana e përmbarruesit privat e më pastaj ka mundësi që të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.850/23, me datë 13.05.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami d.v.**